



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 4 prill 2018
Nr. ref.: RK 1206/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI79/17

Parashtrues

Vahide Badivuku

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, AA. nr. 01/2017,
të 8 shkurtit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Vahide Badivuku, me banim në Vushtrri (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 01/2017, të 8 shkurtit 2017, me të cilin ishte refuzuar si e papranueshme parashtrësja e parashtrueses së kërkesës kundër Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK. nr. 501/2016, të 21 dhjetorit 2016 dhe Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. DP-002-2017, të 17 janarit 2017.
3. Vendimi i kontestuar iu dorëzua parashtrueses së kërkesës më 6 mars 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës të garantuara me paragrafët 2 dhe 5, të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesë] dhe 47 [Kërkesë Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 5 korrik 2017, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 13 korrik 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 25 korrik 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.
9. Më 27 korrik 2017, Gjykata pranoi komente nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.
10. Më 11 janar 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesja e kërkesës ka punuar si prokurore e shtetit në Departamentin e Krimeve të Rënda pranë Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

12. Më 23 shtator 2015, Komisioni Disiplinor (Vendimi KPK/KD/nr. 12/2015) në Këshillin Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Komisioni disiplinor) “vërtetoi se prokurorja Vahide Badivuku, ka kryer sjellje të pahijshme profesionale” dhe shqiptoi masën disiplinore të suspendimit pa pagesë.
13. Më 5 tetor 2017, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë pranë Këshillit Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK) “për shkak të vërtetimit të gabuar apo provave jo të plota të situatës faktike dhe zbatim i gabuar të ligjit për sanksionin”.
14. Më 8 tetor 2015, KPK-ja (Vendimi KPK/KD/nr. 260/2015) e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës, si të pabazuar.
15. Më 17 nëntor 2016, Komisioni Disiplinor (Vendimi KPK/KD/nr. 08/2016) “i shqiptohet masa disiplinore Propozim [Presidentit të Republikës] për largim nga detyra e Prokurorit të Shtetit (...), për shkak se është shpallur fajtorë për veprën penale Marrje e ryshfetit (...) dhe veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar (...) si edhe dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të funksionit në Administratën Publike ose shërbimin publik për periudhën kohore prej 3 (tri) viteve”.
16. Komiteti Disiplinor e bazoi vendimin e tij duke iu referuar Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR. nr. 652/2015, të 5 prillit 2016, me të cilin parashtruesja e kërkesës është shpallur fajtorë për veprat penale për të cilat akuzohej dhe është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, PAKR. 350/2016, të 19 shtatorit 2016.
17. Më 9 dhjetor 2017, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Këshillin Prokurorial të Kosovës, duke pretenduar që “Komisioni Disiplinor i Këshillit Prokurorial të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së vendimit, ka shkelur dispozitat e procedurës disiplinore, nuk ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, e mos të flasim për shqiptimin e masës disiplinore propozimi për largim nga detyrat e Prokurorit të Shtetit”.
18. Parashtruesja e kërkesës pretendoi se ajo ende nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të lartpërmendura të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit ende ishte në pritje pranë Gjykatës Supreme.
19. Më 21 dhjetor 2016, KPK (Vendimi KPK/KD/nr. 501/2016) hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoi Vendimin e Komisionit Disiplinor. Përveç kësaj, KGJK-ja “i rekomandon Presidentit ta shkarkojë znj. Vahide Badivuku nga detyra e prokurores”.
20. Më 17 janar 2017, Presidenti i Republikës së Kosovës (Dekreti nr. DP-002-2017) dekretoi “Znj. Vahide Badivuku shkarkohet nga funksioni i prokurores së shtetit” dhe se “ky Dekret hyn në fuqi në datën e nënshkrimit”.
21. Më 27 janar 2017, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër Vendimit (KPK nr. 501/2016) të KPK-së dhe Dekretit (nr. DP-002-2017) të Presidentit të Republikës së Kosovës, duke pretenduar që “kanë

shkelur të drejtën materiale, përkatësisht dispozitat e Kushtetutës me rastin e shqiptimit të masës disiplinore propozim për largim nga detyra e Prokurorit të Shtetit”.

22. *Parashtruesja e kërkesës pohoi që “fare nuk priti që unë t’i shfrytëzoj të gjitha mjetet e jashtëzakonshme juridike, siç është kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e cila është në procedurë të vendosjes pranë Gjykatës Supreme të Kosovës”.*
23. *Më 8 shkurt 2017, Gjykata Supreme (E. Rev. nr. 01/2017) refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të palejuar, sepse “sipas nenit 104, pika 5, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, (...) gjyqtarët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimit mbi shkarkim drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës”; ndërsa në asnjë dispozitë kushtetuese apo në ndonjë ligj tjetër nuk është paraparë “e drejta e ankesës drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër një vendimi të Këshillit Prokurorial të Kosovës apo vendimit për shkarkim”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. *Parashtruesja e kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 102 (2) dhe (5) të Kushtetutës, i cili “siguron qasje të barabartë në gjykata” dhe garanton “të drejtën e ankesës ndaj një vendimi gjyqësor (...)”.*
25. *Parashtruesja e kërkesës pretendon se neni 104 (5) i Kushtetutës “flet për gjyqtarët dhe (...) në mënyrë analoge duhet të vlejë edhe për prokurorët”.*
26. *Parashtruesja e kërkesës mbështetet në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (Brumarescu kundër Rumanisë) për të pretenduar që “refuzimi i një gjykate që të pranoj juridiksionin për të zgjedhur një çështje të parashtruar para saj me arsyetim se gjykatat nuk kanë kompetencë për të vlerësuar kërkesën për kontrollë ndaj ndonjë shkelje të një të drejte të caktuar të njeriut (...) u konsiderua shkelje e së drejtës për qasje në gjykatë”.*
27. *Parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon se vendimi i kontestuar është nxjerrë edhe pse “procedura penale (...) ende nuk ka përfunduar në të gjitha instancat gjyqësore” pasi që “lënda gjendej në Gjykatën Supreme sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë” dhe kështu “nuk është vërtetuar fajësia ime”.*
28. *Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës konsideron që Gjykata Supreme “ka bërë shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë, pasi që në këtë mënyrë dështoi që të merret me rastin e një shkeljeje individuale dhe kjo e ndërlikohet edhe shkeljen e të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm”.*
29. *Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata “të vërtetojë se është shkelur e drejta [e saj] për qasje në gjykatë” dhe “që kjo çështje të kthehet në Gjykatën Supreme për ta shqyrtuar çështjen e vendimeve disiplinore dhe Dekretin e shkarkimit”.*

Komentet e KPK-së

30. KPK-ja sapo ka njoftuar se *“ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit”* dhe në bazë të tij ka vendosur *“për aprovimin e vendimit të Komisionit Disiplinor për shqiptimin e masës disiplinore propozim për largim nga detyra e Prokurorit të Shtetit”*.

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
32. Në lidhje me këtë, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.
[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

33. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht [...]”.

34. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, e konteston aktin e Gjykatës Supreme si autoritet publik, i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion të saj dhe e ka dorëzuar kërkesën e saj brenda afatit prej katër (4) muajsh.

35. Megjithatë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

36. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) “Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij ...”.

37. Gjykata rikujton që parashtruesja e kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i ish-in shkelur të drejtat e garantuara me nenin 102 (2) dhe (5) të Kushtetutës, i cili “siguron qasje të barabartë në gjykata” dhe garanton “të drejtën e ankesës ndaj vendimit gjyqësor”. Në lidhje me këtë, parashtruesja e kërkesës pretendon se neni 104 (5) të Kushtetutës “flet për gjyqtarët që (...) në mënyrë analoge duhet të vlejë edhe për prokurorët”.
38. Gjykata vëren se Gjykata Supreme në vendimin e saj konsideroi se “sipas nenit 104, pika 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, (...) gjyqtarët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave”. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme ka vendosur që dispozita kushtetuese apo ligji tjetër të përcaktojë “kundër një vendimi të Këshillit Prokurorial të Kosovës apo vendimit për shkarkim është paraparë e drejta e ankese drejtpërdrejt Gjykatës Supreme të Kosovës” dhe rrjedhimisht e hodhi poshtë kërkesën e parashtrueses së kërkesës si të palejueshme.
39. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se nuk mund të vërtetohet se ekziston arbitraritet në interpretimet e dhëna nga Gjykata Supreme. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme ka arsyetuar drejt dhe ka konstatuar se e drejta për të parashtruar ankesë drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër një vendimi të Këshillit Prokurorial të Kosovës ose dekretit për shkarkim, nuk është paraparë me dispozitat kushtetuese dhe as me ligjin e aplikueshëm.
40. Në fillim, Gjykata rikujton nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave të të Drejtave të Njeriut], i cili përcakton se “të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Prandaj, Gjykata Kushtetuese si “autoritet përfundimtar në Kosovë për interpretimin e Kushtetutës” (neni 112 i Kushtetutës), është e detyruar të marrë parasysh praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së gjatë vlerësimit të shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.
41. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se e drejta për qasje në gjykatë nuk është dhe nuk mund të jetë absolute. Në të vërtetë, ajo ka qenë subjekt i kufizimeve (sidomos kur është fjala për supozimet lidhur me pranueshmërinë e mjeteve juridike), pasi që kërkon rregullimin e shtetit sipas natyrës së vet, i cili ka një liri të caktuar vlerësimi në këtë drejtim. Megjithatë, kufizimet e tilla nuk do të zvogëlojnë qasjen në gjykatë në mënyrë të tillë apo në një masë të tillë që të shkelet thelbi i “së drejtës në gjykatë”. Kufizimet e tilla gjithashtu nuk do të konsiderohen në pajtim me nenin 54 të Kushtetutës, përveç nëse ato janë të parapara për arritjen e një qëllimi legjitim ose nuk ka marrëdhënie të

arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të shrytëzuara dhe qëllimit të synuar.

42. Gjykata Kushtetuese vëren se parashtuesja e kërkesës kishte qasje në Gjykatën Supreme, por vetëm në masën në të cilën ankesa e saj ishte hedhur poshtë si e palejueshme. Gjykata Supreme, duke interpretuar Kushtetutën, konsideroi se e drejta për të parashtuar ankesë në Gjykatën Supreme në rast të shkarkimit nga detyra u është dhënë gjyqtarëve, por jo prokurorëve.
43. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtueses së kërkesës nuk i ishte mohuar e drejta e qasjes në Gjykatë, ndërsa ankesa e saj ishte refuzuar për shkaqe procedurale. Parashtuesja e kërkesës mund ta kishte realizuar të drejtën e saj për mjet juridik në një gjykatë tjetër kompetente, në pajtim me ligjin e aplikueshëm.
44. Gjykata më tej konsideron se dyshimet e thjeshta lidhur me efektivitetin e një mjeti juridik të caktuar nuk do ta lirojë parashtuesin nga detyrimi për ta shfrytëzuar atë (Shih rastin e GJEDNJ-së *Epözdemir kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 57039/00, Vendim për pranueshmëri, i 31 janarit 2002).
45. Përkundrazi, parashtuesi i kërkesës duhet t'i drejtohet gjykatës së duhur dhe t'i japë asaj mundësinë për ta vlerësuar shkeljen e pretenduar të të drejtave përmes ushtrimit të kompetencës së saj për interpretim ligjor. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Ciupercescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 35555/03, Aktgjykimi i 15 qershorit 2010, paragrafi 169).
46. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtuesja e kërkesës nuk ka provuar dhe dëshmuar se vendimi i kontestuar ishte i padrejtë ose arbitrar (Shih rastin e GJEDNJ-së *Shub kundër Lituanisë*, kërkesa nr. 17064/06, Vendimi i 30 qershorit 2009).
47. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale, si edhe të asaj materiale (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese, rasti KI70/11, parashtues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
48. Fakti i thjeshtë se parashtuesja e kërkesës nuk është e kënaqur me vendimin e Gjykatës Supreme, nuk mund të ngrejë vetvetiu një pretendim të argumentueshëm për shkelje të Kushtetutës (Shih rasti i GJEDNJ-së *Mezotur Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, kërkesa nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
49. Bazuar në sa u tha më sipër, Gjykata vëren se parashtuesja në kërkesën e saj nuk ka arritur të mbështesë pretendimin e saj për shkeljen e së drejtës për “qasje në gjykatë”.

50. Prandaj, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, Gjykata gjen se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, në nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 janar 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi